

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“DROPULL ENERGY” SH.P.K**

Sot me date 13/10/2022(dymjje e njezet e dy),ne Tirane Shqiperi,ne prezence te njeri tjetrit,u paraqiten personalisht ortaket themelues si më poshtë:

1. **Orest Pirpo**,shtetas shqiptar,i biri i Spiro,lindur ne Gjirokaster,me 11.10.1979,banues ne Tirane,mbajtes i kartes se identitetit me nr.H91011023T,madhore dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar.

Dhe

2. **Kostaq Milo**,shtetas shqiptar,i biri i Pavllo,lindur me 24.06.1963,ne Tirane dhe banues ne Tirane,madhore me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar,identifikuar me karten e identitetit me Nr.G30624085N.

Te cilet hartojne kete Akt Themelimi te shoqerise “**DROPULL ENERGY**” SH.P.K,me emer tregtar “**DROPULL ENERGY**”,mbeshtetur ne ligjin nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” i ndryshuar,ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” i ndryshuar,Kodin Doganor,Fiskal e Tatimor,si me poshte:

KREU 1
Neni 1
Krijimi

Shoqeria “**DROPULL ENERGY**” SH.P.K,eshte person juridik i te drejtes shqiptare,Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit(QKB),në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.
Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqeria “**DROPULL ENERGY**” SH.P.K,eshte nje shoqeri,që themelohet ndërmjet ortakeve që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3
Selia

Shoqeria e ka seline ne Zona Industriale Gjirokaster ,nr.pasurie 13/54 zona kadastrale 8543, Gjirokaster ,Shqiperi.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie,dege,te krijoje filiale,si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise,vetem me vendim te Ortakeve te Shoqerise.

Neni 4
Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie eshte:

- a) Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaikë, eolike, hidrike) te energjise elektrike, te cilat shfrytezojne burimet e rrinovueshme te energjise si dielli, era, uji, si dhe i veprave te tyre ndihmese.
- b) Aplikimi dhe marrja nga qeveria shqiptare apo institucionet përgjegjëse të shtetit shqiptar i te gjitha lejeve, licencave dhe autorizimeve paraprake/perfundimtare, te cilat mundesojne zhvillimin e ketyre aktiviteteve ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi në Republiken e Shqiperise.
- c) Shitia me shumicë dhe pakicë e energjisë elektrike tek operatorët, furnizuesit, tregtaret, konsumatoret e energjisë elektrike (vendas apo te huaj), si dhe ne Bursën Shqiptare të Energjise Elektrike, apo Bursat e tjera jashtë vendit.

Neni 5
Kohezgjatja

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise “DROPULL ENERGY” SH.P.K,eshte e pakufizuar.

KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 lekë(NJEQIND MIJE),i ndare ne dy kuota.

- a) Ortaku z.**Orest Pirpo**,eshte zoterues i nje kuote me vlore nominale 37.000 leke,qe perben 37 % te kapitalit themeltar.
- b) Ortaku z.**Kostaq Milo**,eshte zoterues i nje kuote me vlore nominale 63.000 leke,qe perben 63 % te kapitalit themeltar.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund te përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund te jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku,që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë,ka të drejtë

t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërbëlimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3(tre)vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7
Mënyra te fitimit dhe kalimit të kuotave

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

1. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
2. Statuti mund të kushtëzojë kalimine kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.
3. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartoherë në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmérinë apo regjistrimin e kontratës. Me përashtim të rasteve kur parashikohet shprehimi i ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formalitetave të ndryshme me efekt deklarativ, përfshiri këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE


Neni 8
Organ i Vendimmarrës

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modalitetave te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gi) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;



- h)miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i)Kreditimin ne çfaredo banke apo institucion finanziar kreditor.
- j)çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme,në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme,e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9 Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga një Administrator,**znj. Valbona Lloha**,i cili sipas statutit dhe ligjit emerohet per një periudhe **5 - vjecare** me te drejte riperteritje.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe një person jashtë ortakerise.

Neni 10 Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a)kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b)përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c)kuideset përmajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- c)përgatisi dhe nënshkruejë bilancin vjetor,bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme përmiratim;
- d)krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh)kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënët e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin përmiratim;
- e)raportojë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë)kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm.Administratori përfaqëson Shoqërinë përparrë të gjitha personave fizike e juridike,publike dhe/ose private vendas apo të huaj,autoritetet e shtetërore Shqiptare apo të huaja,përfshi këtu autoritetet gjyqësore të te gjitha shkalleve,prokurorive te te gjitha shkalleve,bankat e te gjitha niveleve etj.Administratori ka të gjitha kompetencat përmiratim, përparrë asamblesë së përgjithshme në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë,si perpara Bankave te te gjitha niveleve,per te kryer derdhje,terheqje,transferta etj,perpara Zyrate te Tatim

Taksave,Zyrave te Qeverisjes Vendore,Zyrave te Punës,Autoritetet e Doganore etj,në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Neni 11
Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.Perjashtimi, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

Neni 12
Baza Llojore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 13
Mosmarreveshjet


Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij akt themelimi shoqerie, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 14
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 2 ekzemplare me permbajtje dhe vlere te njejtë juridike, ne gjuhen shqipe, u miratua ne parim nen per nen nga Ortaket e shoqerise "**DROPULL ENERGY**" SH.P.K, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale te tyre.

**ORTAKET THEMELUES
TE SHOQERISE "DROPULL ENERGY" SH.P.K**

OREST PIRPO

Orest Pirpo


KOSTAQ MILO

Kostaq Milo
